

116-ta është një numër. Në fakt, ne të gjithë kemi raportin tonë me numrat që mund të jetë i ngrohtë apo i ftohtë. Unë bëj pjesë tek ata që e kanë të ftohtë. Pse numri 116? Në fakt, numri 116 duhej të ishte një numër i ngulitur fort në memorien tonë, por jam i bindur se për shumicën tonë këtu, por edhe për shumicën e atyre që na dëgjojnë, nuk ndodh kështu. Ne kemi të gjithë numra të caktuar të ngulitur thellë në memorie, që mund të jenë numrat e ditëlindjeve të të afërmit tanë, numrat e telefonit të të dashurve tanë, por edhe numri i fanellës së futbollistit të preferuar. Në këto raste të gjithë këta numra nuk janë thjesht numra. Ata lidhen me memorien tonë, sepse janë të lidhur me një ndjenjë njerëzore. Numri 116 duhet të ishte i lidhur pikërisht në këtë mënyrë me memorien tonë. Numri 116, të nderuar kolegë, të dashur shqiptarë, është numri i telefonit që të gjithë fëmijët në rrezik abuzimi ose të abuzuar duhet të telefonojnë për të marrë ndihmën e parë, për të bërë denoncimin e parë. Mua më vjen rëndë të them që edhe unë vetë këtë numër e mora vesh para pak ditësh, më shumë i shtyrë nga dy rastet e abuzimit që ndodhën së fundi ndaj minoreneve.

Në fakt, numra të tillë të ngjashëm kanë të gjitha vendet. Më kujtohet që në Itali është telefono azzurro, por, ndryshe nga ne, është një numër telefoni që nuk ka italian që nuk e di, pavarësisht moshës, seksit apo identitetit. Te ne ndodh ndryshe. Këtë numër telefoni, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, ne nuk e dimë; fëmijët që mund të ndodhen në gjendje rreziku nuk e dinë, por nuk është vetëm ky problemi, sepse do të ishte shumë më e thjeshtë çështja nëse ky numër do t'u bëhej i ditur fëmijëve apo do ta dinin të gjithë ata që do t'u nevojitej në rast nevojë. Çështja kryesore është që unë provova t'i bie këtij numri telefoni dhe ky numër telefoni nuk ekziston. Imagjinoni, të nderuar kolegë, të dashur shqiptarë, një fëmijë që ndodhet në rrezik abuzimi të marrë në telefon për të kërkuar ndihmë dhe ajo që merr si përgjigje të jetë "the sound of silence". I imagjinoni, të dashur kolegë, që një fëmijë, i cili ndodhet në rrezik abuzimi, t'i bjerë një numri telefoni, që duhej të ishte instituti i parë mbrojtës për jetën e tij, për atë vetë, dhe ajo që merr është, në fakt, jo një dorë që do ta nxirrte nga thellësia e errësirës, por janë ato që do të shndërrohen në refrenin e tij të së përditshmes: "Hello darkness, my old friend! I come here to talk with you again".

Të nderuar kolegë, ne mund të miratojmë plot akte normative, mund të miratojmë pa fund amendamente, mund të sigurojmë edhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por për sa kohë në këtë vend do të jetë qoftë edhe një fëmijë i vetëm, i cili do të ketë nevojë të kërkojë ndihmë dhe nuk do të ketë ku ta kërkojë këtë ndihmë të parë, ne nuk kemi arritur sukses, për të mos thënë që kemi dështuar. Një prind troket fort në dyert e shtetit dhe unë jam prind. Një deputet shërben si çelës që këto dyer të shtetit të hapen, kur ato janë mbyllur, dhe unë jam deputet. Një deputet socialist nuk rresht së përpjekuri, derisa këto dyer të kthehen në dyert e një kështjelle që çdo fëmijë shqiptar të ndihet i sigurt dhe i mbrojtur.

Unë jam deputet socialist dhe këtu para jush sot zotohem për një gjë shumë të thjeshtë: numri 116 do të regjistrohet fort në memorien e çdo fëmijë që do të ketë nevojë, që do të ndihet në rrezik apo do të jetë i abuzuar dhe siguroj që ky nuk do të jetë hapi i parë. Aksione të tjera do ta ndjekin. Ju ftoj që këtu, në këtë drejtim, ne të jemi të gjithë bashkë, sepse nuk jemi as të majtë, as të djathtë, por jemi shqiptarë dhe bëhet fjalë për fëmijët tanë. Duhet të jemi të gjithë bashkë. Faleminderit!